



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra

Mars

2000

Akte të papublikuara

Dhjetor 1998

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i KM nr.764, datë 8.12.1998	Për mënyrën e përballimit të subvencionit për ndërmarrjet e ujësjellësit.....	5
Vendim i KM nr.766, datë 8.12.1998	Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike, ushtarake të rëndësisë së veçantë.....	5
Vendim i KM nr.768, datë 8.12.1998	Për caktimin e përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës.....	7

Vendim i KM nr.773, datë 11.12.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 11.11.1998 “Për prokurim të drejtpërdrejtë për blerjen e materialeve dhe pajisjeve për Qytetin Studenti”.....	8
Vendim i KM nr.776, datë 8.12.1998	Për grumbullimin dhe depozitimin e detyruar të automjeteve të braktisura.....	9
Vendim i KM nr.777, datë 17.12.1998	Për dhënie fondesh për kryerjen e pagesave dhe shpërblimin e punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes..	10
Vendim i KM nr.781, datë 17.12.1998	Për një ndryshim në vendimin nr. 569, datë 29.11.1994 “Për pagesën dhe shpërblimin e futbollistëve të Ekipit Kombëtar, kur grumbullohen për ndeshje ndërkombëtare”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.111, datë 27.2.1995.....	10
Vendim i KM nr.782, datë 17.12.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 3.5. 1995, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar””.....	11
Vendim i KM nr.786, datë 17.12.1998	Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë....	11
Vendim i KM nr.787, datë 17.12. 1998	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 18.10.1998, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e familjeve për nxënësit dhe studentët”.....	19
Vendim i KM nr.788, datë 17.12.1998	Për një shtesë në vendimin nr. 537, datë 26.9.1994 “Për shtesë mbi pagën për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit”..	20
Vendim i KM nr.789, datë 24.12.1998	Për platformën e funksionimit të Ministrisë së Informacionit.....	20
Vendim i KM nr.791, datë 24.12.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit”.....	22

Vendim i KM nr.796, datë 24.12.1998	Për të ardhurat e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK), për shpërblimet e këshillave miratuese të projekteve, të Komisionit të Vizionimit dhe të Komisionit Financiar.....	22
Vendim i KM nr.798, datë 24.12.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 54, datë 2.2. 1996 “Për listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave”.....	24
Vendim i KM nr.802, datë 24.12.1998	Për shitjen e pasurive të shoqërive në administrim “Universi”, sh.p.k., “Nahlel” sh.p.k., “Aserd” sh.p.k., për rikompensimin e vlerave financiare kreditorëve të tyre.....	25
Vendim i KM nr.804, datë 24.12.1998	Për mbylljen e procesit të kontrollit dhe të administrimit për shoqëritë “Agroni” sh.p.k. dhe “Kambo Marshall” sh.p.k.....	26

V E N D I M

Nr. 764, datë 8.12.1998

PËR MËNYRËN E PËRBALLIMIT TË SUBVENCIONIT PËR NDËRMARRJET E UJËSJELLËSIT

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2. 1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1998”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për përballimin e shpenzimeve për subvencionimin e Ndërmarrjes së Ujësjellësit, i shtohet një fond prej 62 556 000 (gjashtëdhjetëdy milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekë, nga të cilat 5 000 000 (pesë milionë) lekë t’i kalojnë Ndërmarrjes së Ujësjellësit, Durrës, për ruajtjen e stacionit të pompave të Fushë-Kuqes.

2. Efektet financiare, të fondit prej 62 556 000 (gjashtëdhjetëdy milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekësh, të përballohen nga buxheti i miratuar prej vitit 1998 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, duke ulur 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet e varrimit dhe 49 556 000 (dyzetënëntë milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekë nga investimet e përealizuara nga buxheti i kësaj ministrie për vitin 1998.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 766, datë 8. 12. 1998

PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE, USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 100, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Për kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit e disa linjave teknologjike, ushtarake të rëndësisë së veçantë, të cilat

prej disa vjetësh kanë ndërprerë punën për shkak të mungesës së porosive, por që për nevojat e mbrojtjes së vendit duhet të mbahen në gadishmëri, duke filluar nga data 1 janar 1999, përfitojnë pagën mesatare të muajit dhjetor 1998, të rritur 20 për qind. Në këtë rritje përfshihen dhe kompensimet. Paga për secilin punonjës të diferencohet sipas shkallës së kualifikimit. Këtyre punonjësve, për çdo vit pune, u jepet shtesë për vjetërsi pune 1 për qind mbi pagën, por jo më shumë se 25 për qind.

Kjo pagesë synon mbajtjen në gatishmëri të punonjësve, për t'iu përgjigjur nevojave emergjente të mbrojtjes. Pagesa të jepet për një periudhë kohe deri në dy vjet.

2. Të drejtën për t'u trajtuar sipas pikës 1 të këtij vendimi e përfitojnë punonjësit e linjave të prodhimit ushtarak të Kombinatit Mekanik, Poliçan, të Uzinës së Lëndëve Plasëse, Mjekës, Uzinës Mekanike dhe Uzinës së Pilave, Gramsh, të cilët kanë përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 13.1.1997 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 14.6.1997, dhe që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë qenë të punësuar në këto ndërmarrje, pa ndërprerje, për një periudhë kohore jo më pak se 2 vjet, dhe që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit ose të vetëpunësimit, dhe nuk kanë ndryshuar vendbanimin familjar.

Këta punonjës janë të detyruar që, me kërkesën e drejtorive të ndërmarrjeve, të marrin pjesë në ritrajnimin periodik, lëshimin e linjave teknologjike për kontroll, në eksperimentime, në mirëmbajtjen e linjave, në kryerjen e deri dy cikleve të punës në vit, me afat në dy muaj, si dhe në punët e nevojshme publike, në nivel lokal. Për punonjësit që nuk zbatojnë detyrimet e mësipërme të ndërpritet pagesa e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Pagesën e gadishmërisë e përfitojnë 1 270 punonjës të Kombinatit Mekanik Poliçan, 200 punonjës të Uzinës së Lëndëve Plasëse, Mjekës, 100 punonjës të Uzinës Mekanike, Gramsh dhe 30 punonjës të Uzinës së Pilave, Gramsh. Në listat e punonjësve që do të trajtohen me pagesë sipas pikës 1 të këtij vendimi, t'u jepet përparësi specialistëve, me shkallë kualifikimi më të lartë dhe me stazh pune më të gjatë dhe punonjësve të atyre linjave teknologjike që kanë ndërprerë punën, por që, në kohë të afërt, parashikohen të vihen në punë.

Brenda numrit mesatar të miratuar të punonjësve që mbahen në gatishmëri për secilën ndërmarrje, në vend të punonjësve që largohen për efekt të daljes në pension, ose shkëpusin lidhjet me ndërmarrjet, për shkak të ndryshimit të vendbanimit familjar ose për shkaqe të tjera, me vendim të këshillave drejtuese të ndërmarrjeve mund të merren punëtorë të veçantë, me kualifikim të lartë, që më parë kanë qenë në marrëdhënie pune me këto ndërmarrje, e që janë të nevojshëm për mbajtjen në gatishmëri të linjave teknologjike.

4. Gjatë kohës së trajtimit me këtë vendim, shuma e të ardhurave mujore për këta punonjës rritet në të njëjtën masë që do të rriten të ardhurat e personave që përfitojnë pagesë papunësie.

5. Efekti ekonomik vjetor për kryerjen e pagesës sipas pikës 1 të këtij vendimi të programohet në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila ngarkohet me kryerjen e kësaj pagese, nëpërmjet zyrave të punës të rretheve përkatëse.

6. Periudha e pagesës së punonjësve, sipas këtij vendimi, llogaritet, për efekt pensioni, vjetërsi pune në profesionin e mëparshëm dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për këta punonjës të përballohen nga shteti të gjitha llojet e kontributeve, të parashikuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 13.1.1997 “Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike, ushtarake, në kushte të vështira për vazhdimin e veprimtarisë prodhuese” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 768, datë 8.12.1998

PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE DHE PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve, në Këshillin Kombëtar të Punës, të jenë si vijon:

PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE

1. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH)	3 anëtarë	3 kandidatë
2. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)	3 anëtarë	3 kandidatë
3. Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH)	1 anëtar	1 kandidat
4. Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH)	1 anëtar	1 kandidat
5. Tryeza sindikale	1 anëtar	1 kandidat
6. Lidhja Autonome e Sindikatave të Shqipërisë (LASSH)	1 anëtar	1 kandidat

PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE

1. Konfederata e Biznesmenëve Shqiptarë (KOBIZ)	2 anëtarë	2 kandidatë
2. Konfederata e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (KNVM)	2 anëtarë	2 kandidatë
3. Organizata e Sipërmarrësve të Lirë të Shqipërisë (OSLSH)	3 anëtarë	3 kandidatë
4. Unioni i Punëdhënësve të Shqipërisë (UPSH)	1 anëtar	1 kandidat
5. Tirana Biznes (TIR-BIZ)	1 anëtar	1 kandidat
6. Organizata e Fermerëve Shqiptarë (OFSSH)	1 anëtar	1 kandidat

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të KKP-së bëhet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, me propozimin e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 875, datë 23.12.1996 “Për emërimin e antarëve dhe kandidatëve në Këshillin Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 773, datë 11.12.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 713, DATË 11.11.1998 “PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË PËR BLERJEN E MATERIALEVE DHE PAJISJEVE PËR QYTETIN STUDENTI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 11.11.1998, në pasqyrën nr.1 bashkëlidhur, zëri “Kaloriferë 2000 w (me vaj, me radiacion), fondi limit 15 300 000 lekë, copë 1500”, ndryshohet si vijon:

“Kaloriferë 1500 w (me vaj, me radiacion), fondi limit 15 300 000 lekë copë 1780, shoqëria “IM Intermediacione sh.p.k.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 776, datë 8.12. 1998

PËR GRUMBULLIMIN DHE DEPOZITIMIN E DETYRUAR TË AUTOMJETEVE TË BRAKTISURA

Në mbështetje të ligjit nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar dhe të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sheshet për grumbullimin dhe depozitimin e automjeteve të braktisura përcaktohen nga këshillat e rretheve, me miratimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbështetur edhe në kërkesat e subjekteve, fizike dhe juridike.

2. Pronarët e automjeteve, që do të nxirren jashtë funksionimit, të bëjnë depozitimin e tyre në sheshet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen e organeve të policisë rrugore të Ministrisë së Rendit Publik.

3. Grumbullimi dhe depozitimi i automjeteve të braktisura ose i atyre që do të dalin jashtë funksionimit, të bëhet nëpërmjet licencimit të subjekteve fizike dhe juridike. Licencat jepen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, sipas kriterëve të vendosura për këtë qëllim.

Kriteret për dhënien e licencave të kësaj veprimtarie vendosen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrinë e Rendit Publik, dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

4. Automjeti të pranohet nga subjekti i licencuar vetëm pasi ai të jetë i pajisur me dokumentin, që vërteton çregjistrimin e mjetit dhe dorëzimin e dokumenteve dhe targave në organin që bën regjistrimin.

5. Fondet për veprimtarinë e grumbullimit dhe të depozitimit të automjeteve të braktisura, që do të dalin jashtë funksionimit, përballohen nga subjektet e licencuara.

6. Kundrejt pronarëve, që braktisin automjetin, jashtë vendeve të përcaktuara nga këshilli i rrethit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të merren masa administrative, në përputhje me ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Rendit Publik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe këshillat e rretheve për hartimin e rregulloreve, caktimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 777, datë 17.12.1998

PËR DHËNIE FONDESH PËR KRYERJEN E PAGESAVE DHE SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998, “Për buxhetin e shtetit për vitin 1998”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, në zërin “paga”, i shtohen 15 milionë lekë. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Në buxhetin e shtetit të miratuar për vitin 1998 për Ministrinë e Mbrojtjes, shuma prej 10 milionë lekësh parashikuar në zërin “shpenzime operative”, të kalojë në zërin “paga”.

3. Në buxhetin e shtetit të miratuar për vitin 1998 për Ministrinë e Mbrojtjes, shuma prej 35 milionë lekësh e fondeve të kushtëzuara në zërin “shpenzime operative”, të përdoret për të mbuluar pagat e punonjësve të ushtrisë, pagesat për kohën e qëndrimit të tyre në gatishmëri, për kryerjen e shpërblimeve si rezultat i privacioneve dhe vështirësive në kryerjen e detyrave të ngarkuara.

4. Kriteret dhe masat e shpërblimeve të përcaktohen nga ministri i Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 781, datë 17.12.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 569, DATË 29.11.1994 “PËR PAGESËN DHE SHPËRBLIMIN E FUTBOLLISTËVE TË EKIPIT KOMBËTAR, KUR GRUMBULLOHEN PËR NDESHJE NDËRKOMBËTARE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.111, DATË 27.2.1995

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.569, datë 29.11.1994, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Futbollistët, tre trajnerët, mjeku dhe masazhatori i ekipit kombëtar të futbollit, gjatë ditëve të grumbullimit stërvitor për ndeshje ndërkombëtare (duke përfshirë edhe ditët e ardhjes dhe ikjes), paguhen në masën deri 70 USD në ditë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 782, datë 17.12. 1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 190, DATË 3.5. 1995, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7874, DATË 17.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR””

Në mbështetje të nenit 15, të ligjit nr. 7874, datë 17.11. 1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 3.5.1995, në pikën 3 fjala “**nënministër**” të ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalën “**zëvendësministër**”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 786, datë 17.12.1998

PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR DHE PËR KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE, PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË

Në mbështetje të nenit 37, të ligjit nr. 7810, datë 6.4. 1994, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dispozita të përgjithshme

1.1. Sistemi i kualifikimit shkencor, pasuniversitar ka si qëllim përgatitjen e specialistëve, të aftë për të kryer veprime kërkimore-shkencore e pedagogjike, me rezultate të nivelit bashkëkohor. Ky kualifikim kryhet në dy faza, nëpërmjet dhënies së gradave e titujve shkencore, në përputhje me kriteret dhe klasifikimin e përcaktuar në këtë vendim.

1.2. Faza e parë e kualifikimit shkencor, pasuniversitar fillon me marrjen e diplomës së studimeve të thelluara pasuniversitare dhe përfundon me mbrojtjen e doktoratës “Doktor i shkencave”. Faza e dytë, e cila lidhet në karrierën shkencore, fillon me mbrojtjen e doktoratës “Doktor i shkencave” dhe përfundon me marrjen e titujve “Profesor” ose “Drejtues kërkimesh”.

1.3. Komisioni i Kualifikimit Shkencor, i ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave, cakton institucionet, që kanë të drejtë të organizojnë kualifikimin shkencor, pasuniversitar, të japin diplomën e studimeve të thelluara pasuniversitare për gradën shkencore “Doktor i shkencave”. Ky komision, në përputhje me këtë studim, përcakton kriteret e klasifikimit pedagogjik e shkencor dhe kontrollon zbatimin e tyre në praktikë.

2. Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare (DSTP)

2.1. Për marrjen e diplomës së studimeve të thelluara pasuniversitare organizohen shkolla pasuniversitare, pranë shkollave të larta universitare, të përcaktuara me vendim të veçantë të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

2.2. Qëllimi themelor i shkollave pasuniversitare është përgatitja më e thelluar, teorike e praktike, e kandidatit në fushën që do të lëvrojë, përvetësimi i metodave të punës kërkimore-shkencore dhe përgatitja e një mikroteze, niveli i së cilës përcaktohet me udhëzim të veçantë të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

2.3. Në rastet kur nuk ka mundësi të hapet shkolla pasuniversitare, e rregullt (me shkëputje nga puna), si dhe, në raste të veçanta, të disa specialiteteve të posaçme, mund të ngrihet shkolla pasuniversitare me korrespondencë, nën drejtimin e departamentit përkatës.

Në përputhje me udhëzimin e Komisionit të Kualifikimit Shkencor dhe të Drejtorisë së Arsimit të Lartë, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, institucionet e parashikuara për ngritjen e shkollave pasuniversitare hartojnë planin mësimor, për realizimin e tyre. Plani mësimor miratohet nga dekanati i fakultetit dhe vendoset në dosjen e kandidatit. Në çdo rast, detyrimet e programit të shkollës pasuniversitare ose të programit të veçantë, duhet të shlyhen dy vjet përpara mbrojtjes së disertacionit të doktoratës në jurinë përkatëse).

2.4. Propozimi për hapjen e shkollave pasuniversitare bëhet nga këshillat shkencore të fakulteteve. Këtij propozimi i bashkëlidhet dokumentacioni i mëposhtëm:

- relacioni shpjegues për motivet e hapjes së shkollës pasuniversitare;
- plani mësimor i saj;
- afatet kohore të realizimit të shkollës pasuniversitare;
- titulli i diplomës, që do të jepet nga shkolla pasuniversitare;
- gjuha e huaj, me programin pasuniversitar, që duhet të japë kandidati (anglisht, frengjisht, rusisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
- burimet e financimit të shkollës pasuniversitare;

- garancitë për personelin pedagogjiko-shkencor, që do të mbulojë realizimin e shkollës pasuniversitare.

Në ekipet mësimore mund të përfshihen dhe punonjës të jashtëm, me kualifikim të lartë, pedagogjik e shkencor, të miratuar nga dekani i fakultetit përkatës.

Propozimi së bashku me mendimin e senatit të universitetit ose të shkollave të larta, (propozimi shqyrtohet detyrimisht nga senati i universitetit ose i shkollave të larta), i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2.5. Afati i shkollës pasuniversitare është 1 deri në 2 vjet, në varësi të kushteve konkrete të zhvillimit të saj.

2.6. Në shkollën pasuniversitare pranohen kandidatë me shtetësi shqiptare e të huaj, që kanë mbaruar shkollën e lartë, brenda ose jashtë shtetit, me mesatare pikësh jo më poshtë se 80 për qind e pikëve maksimale të shkollës përkatëse. Kandidatët, në të gjitha rastet, pranohen me konkurs. Përjashtimet, për raste të veçanta, mund të bëhen vetëm nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2.7. Kërkesa për pranim në shkollën pasuniversitare paraqitet nga të interesuarit, pranë fakultetit përkatës dhe përmban:

- diplomën e shkollës së lartë, së bashku me dëftesën e notave;
- curriculum vitae;
- fushën e studimeve për specialistët e dëshiruar;
- rekomandimin nga një institucion ose dy studiues përkatës, me gradë a titull shkencor;
- certifikata provimesh a botimesh, të realizuara nga kandidati;
- deklaratën vetjake ose vërtetimin për përballimin e shpenzimeve të shkollës pasuniversitare, të caktuara për çdo kandidat, sipas pikës 6.1.

Vendimi i motivuar, për pranimin ose mospranimin e kërkesës, jepet nga dekani i fakultetit, ku është depozituar kërkesa. Ankesat kundrejt këtij vendimi mund të bëhen pranë rektoratit të universitetit, vendimi i të cilit është përfundimtar.

2.8. Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare u jepet kandidatëve, që realizojnë me sukses detyrimet e planit mësimor, gjuhën e huaj, si dhe mikrotezën. Mikroteza mbrohet përpara një komisioni të posaçëm dhe në diplomën, që i jepet kandidatit, shënohet fusha dhe specialiteti përkatës. Diploma firmoset, përkatësisht nga dekani i fakultetit, si dhe nga rektori i këtij universiteti apo drejtori i asaj shkolle të lartë. Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare shoqërohet me listën e lëndëve dhe me vlerësimet përkatëse.

3. Doktorata

3.1. Doktorata organizohet pranë shkollave të larta universitare dhe pranë instituteve e qendrave kërkimore, të përcaktuara sipas pikës 1.3.

3.2. Qëllimi i doktoratës është përgatitja e specialistëve të kualifikuar për punë kërkimore-shkencore, mbi bazën e formimit të fituar në shkollat pasuniversitare, nëpërmjet hartimit të një disertacioni. Tematika e disertacioneve të doktoratës përcaktohet sipas programeve për kërkim e zhvillim, që kanë shkollat e larta dhe institucionet kërkimore e shkencore. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me shkollat e larta dhe institutet e përcaktuara në pikën 1.3, harton, për këtë vit, planin e pranimi të kandidatëve për doktoratë.

3.3 Disertacioni i doktoratës kryhet nën drejtimin e udhëheqësit shkencor (së paku “Profesor i asociuar” ose “Mjeshtër kërkimesh”). Afati i përgatitjes dhe i mbrojtjes së disertacionit është 3-5 vjet. Gjatë kësaj periudhe disertanti duhet të ketë botuar të paktën 2 artikuj shkencorë.

3.4. Në rastet e parashikuara në pikën 2.3, afati i përgatitjes së disertacionit është 2-3 vjet të kryerjes së shkollës pasuniversitare.

3.5. Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit përcaktohen me rregullore dhe sipas udhëzimeve të veçanta të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

3.6. Disertacioni i doktoratës duhet të ketë nivel të lartë shkencor, të pasqyrojë punën e pavarur kërkimore-shkencore të disertantit, kontributin e tij në zgjidhjen e problemeve, që e çojnë përpara shkencën, teknologjinë, ekonominë e kulturën tonë, si dhe të mbështetet në rezultate origjinale, të krahasueshme me rezultatet shkencore bashkëkohore të vendeve të tjera.

3.7. Mbrojtja e disertacionit të doktoratës bëhet përpara jurisë, që ngrihet për çdo disertacion, pranë qendrave të përcaktuara në pikën 1.3. Leja për mbrojtjen e disertacionit jepet nga drejtuesi i institucionit të mësipërm, në bazë të kërkesës së disertantit, të mbështetur, me shkrim, nga udhëheqësi shkencor. Për secilin rast, miratimi për mbrojtjen e doktoratës dhe përbërjen e jurisë jepet nga kryetari i Komisionit të Kualifikimit Shkencor. Juria duhet të përbëhet nga 5 anëtarë, me kualifikim të lartë, 3 prej të cilëve të jashtëm për institucionin, ku është përgatitur disertacioni.

3.8. Pas miratimit të disertacionit të doktoratës nga juria, disertanti merr gradën “Doktor i shkencave”. Regjistrimi i diplomës bëhet pranë sekretarisë së Komisionit të Kualifikimit Shkencor, pasi të jetë firmosur nga kryetari i komisionit.

3.9. Gradat shkencore, të mbrojtura sipas rregullores që ka qenë në fuqi deri në datën 30.6.1993, përpara vendimit të Këshillit të Ministrave nr.351, datë 20.6.1993, bazohen të gjitha, me gradën e re, të vetme “Doktor i shkencave”.

4. Klasifikimi i punonjësve pedagogjikë e kërkimorë

4.1. Klasifikimi pedagogjiko-shkencor i personelit mësimdhënës dhe atij kërkimor bëhet në përputhje me nivelin e kualifikimit, veprimtarinë e zhvilluar, leksionet e dhëna, punimet e kryera, artikujt, tekstet e monografite e botuara, pjesëmarrjen në seminare, kolokiume e konferenca shkencore, brenda dhe jashtë vendit, drejtimin e veprimtarive pedagogjike në shkollat e larta, në lëndë të caktuara ose drejtimin e kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës.

4.2. Punonjësit pedagogjike të universiteteve e të shkollave të tjera të larta, në varësi nga vendi e roli që kanë me veprimtarinë e mësimdhënies dhe nga kontributi i tyre kërkimor-shkencor, klasifikohen si vijon:

4.2.1. **“Profesor” (Prof)** emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, që është “Profesor i asociuar” të paktën prej katër vjetësh, që ka qenë titullar lëndësh a grup lëndësh, që ka udhëhequr diploma të shkollave pasuniversitare ose të shkollës së lartë, si dhe ka udhëhequr të paktën 1 disertacion, që është autor ose bashkautor kryesor i një a më shumë teksteve universitare, të një cilësie të lartë, është hartues programesh për lëndë a cikle lëndësh të veçanta, autor artikujsh shkencorë e monografish ose drejtues projektesh shkencore, që ka drejtuar seksione (katedra), departamente ose ekiye kërkimore në fushën e vet, që ka qenë pjesëmarrës në konferenca shkencore, brenda ose jashtë vendit, dhe ka botuar artikuj a kumtesa jashtë vendit.

Përrjashtimi nga kriteret e mësipërme bëhet vetëm me vendim të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

4.2.2. “Profesor i asociuar” (Prof.as.) emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, që është “Doktor i shkencave”, me përvojë mësimdhënies jo më pak se 10 vjet, që është autor ose bashkautor tekstesh universitare, autor artikujsh e kumtesash, të publikuara brenda dhe jashtë vendit, si dhe autor monografish ose realizues arritjesh të rëndësishme shkencore, që ka udhëhequr diploma të shkollës pasuniversitare ose të shkollës së lartë, si dhe që zotëron, sipas dëshmisë përkatëse, gjuhën angleze, ose, në vend të saj, dy gjuhë të huaja, njëra prej të cilave frëngjishtja dhe tjetra njëra nga gjuhët e huaja, të treguara në listën e pikës 2.4.

4.2.3. “**Lektor**” (Pedagog) është punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, me gradë “Doktor i shkencave”, që jep leksione, që është autor artikujsh shkencorë, që ka udhëhequr diploma universitare.

4.2.4. “**Asistent**” është specialisti i lartë, që zhvillon seminare, ushtrime dhe punë laboratorike pranë njësive mësimdhënëse, i cili përgatitet për t’u bërë “lektor” (pedagog) dhe ndjek shkollën pasuniversitare dhe doktoratën.

4.3. Punonjësit kërkimorë të instituteve dhe të qendrave kërkimore-shkencore dhe ata pranë shkollave të larta, në varësi të nivelit shkencor dhe të kontributit personal, si dhe nga vendi që zënë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, klasifikohen si vijon:

4.3.1. “**Drejtues kërkimesh**” emërohet punonjësi kërkimor, që është “Mjeshtër kërkimesh”, prej jo më pak se 5 vjetësh, e që ka drejtuar kërkime në fushën e vet, është specialist të paktën në një disiplinë të ngushtë, është autor ose bashkautor të paktën i dy monografive shkencore, autor ose bashkautor tekstesh universitare, ka botuar të paktën 10 artikuj ose kumtesa shkencore, nga të cilat pesë jashtë shtetit. Ka udhëhequr të paktën dy disertacione për doktorata dhe ka marrë pjesë, në mënyrë të vazhdueshme, në veprimtari shkencore, brenda dhe jashtë vendit, me komunikime gojore ose postera, i cili, për specialitete të veçanta, në mungesë të monografive dhe të teksteve universitare, ka botuar të paktën 15 artikuj ose kumtesa shkencore, nga të cilat pesë jashtë shtetit. Përrjashtime bëhen me vendim të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

4.3.2. “**Mjeshtër kërkimesh**” emërohet punonjësi kërkimor, me gradë “Doktor i shkencave”, me përvojë studimore jo më pak se 10 vjet, specialist në fushë kërkimesh, që ka botuar të paktën një monografi apo tekst universitar, vetëm ose si bashkautor, që ka botuar të paktën pesë artikuj ose kumtesa shkencore, nga të cilat dy jashtë shtetit që ka marrë pjesë në realizimin e projekteve kërkimore, kombëtare ose ndërkombëtare, me raporte teknike, ose programe informatike, që është aktivizuar në shkolla pasuniversitare, ku ka të tilla, që ka marrë pjesë në konferenca shkencore, brenda ose jashtë vendit, me komunikime gojore ose me postera, që njih sipas dëshmisë përkatëse, gjuhën angleze ose, në vend të saj, dy gjuhë të tjera (sipas pikës 2.4), nga të cilat njëra është frëngjishtja. Për specialitete të veçanta, në mungesë të monografisë a tekstit universitar, ka botuar të paktën 10 artikuj ose kumtesa shkencore, nga të cilat 3 jashtë shtetit.

Përrjashtime bëhen vetëm me vendim të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

4.3.3. “**Punonjës kërkimor**” emërohet punonjësi shkencor, me gradën “Doktor i shkencave”, i ngarkuar me plan të rregullt për kërkime të caktuara shkencore në një fushë dhe që ka botuar të paktën katër artikuj shkencorë.

4.3.4. “**Asistent**” emërtohet specialisti i lartë, ndihmës, i atashuar pranë njësive

kërkimore e shkencore, i cili përgatitet për t'u bërë punonjës kërkimor dhe ndjek shkollën pasuniversitare dhe doktoratën.

4.4. Veprimtaria mësimdhënëse dhe kërkimore për titull “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” shqyrtohet publikisht, në mbledhjen e departamenteve. Vendimi, i marrë me votim të hapet, i përcillet këshillit të fakultetit përkatës, i cili vendos me votim të fshehtë. Në rast se këshilli i fakultetit rrëzon kandidaturën me një shumicë prej dy të tretash dosja nuk i dërgohet senatit të universitetit. Senati i universitetit ose i shkollës së lartë, pas një votimi të fshehtë, ia dërgon dosjen e të interesuarve të Komisionit të Kualifikimit Shkencor, i cili merr vendimin përfundimtar me votim të fshehtë.

4.4.1 Në universitetet, që nuk përfshihen në listën e parashikuar nga pika 1.3. të këtij vendimi, vendimi i senatit të atij universiteti i dërgohet përkatësisht senatit të njërit nga universitetet e parashikuara në pikën 1.3.

4.5. Veprimtaria kërkimore-shkencore e kandidatëve për titullin “Drejtues kërkimesh” dhe “Mjeshtër kërkimesh” shqyrtohet publikisht, në mbledhje të departamenteve ose sektorëve shkencorë. Vendimi i marrë me votim të hapët i dërgohet këshillit shkencor të institutit përkatës, i cili vendos me votim të fshehtë. Në rast se këshilli shkencor i institutit e rrëzon kandidatin, me një shumicë prej dy të tretash, dosja nuk i dërgohet Këshillit Drejtues të Akademisë. Këshilli Drejtues i Akademisë së Shkencave, me votim të fshehtë, ia dërgon dosjen e të interesuarit Komisionit të Kualifikimit Shkencor, i cili merr vendimin përfundimtar, me votim të fshehtë.

4.6. Veprimtaria kërkimore-shkencore e kandidatëve për titullin “Drejtues kërkimesh” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, që punojnë në një institut kërkimor të një dikasteri, shqyrtohet publikisht, në mbledhjen e departamenteve a të sektorëve shkencorë të këtij instituti. Vendimi i marrë me votim të hapët i dërgohet këshillit shkencor të institutit përkatës, i cili vendos me votim të fshehtë. Në rast se këshilli i institutit e rrëzon kandidaturën me një shumicë prej dy të tretat, dosja nuk i dërgohet senatit të universitetit përkatës ose Këshillit Drejtues të Akademisë së Shkencave. Senati i universitetit ose Këshilli Drejtues i Akademisë, pas një votimi të fshehtë, kur kandidati ka fituar, e dërgon dosjen e të interesuarit në Komisionin e Kualifikimit Shkencor, i cili merr vendimin përfundimtar, me votim të fshehtë.

4.7. Në çdo rast, kur kandidatura është rrëzuar, me vendim të formës së prerë, nga fakulteti ose instituti, nga senati i universitetit përkatës ose Këshilli Drejtues i Akademisë së Shkencave apo Komisioni i Kualifikimit Shkencor, kandidati ka të drejtë ta përsërisë kërkesën e vet, pasi të ketë kaluar së paku një vit nga data e vendimit të mësipërm.

4.8. Gradat e titujt e mësipërm, të fituar nga një person, mbahen përgjithmonë, me përjashtim të rasteve kur hiqen me vendim gjyqësor.

4.9. Emërtimet “Profesor” dhe “Drejtues kërkimesh”, “Profesor i asociuar” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, janë, në aspektin zyrtar, plotësisht të barasvlefshme. Personat që mbajnë titullin “Drejtues kërkimesh” ose “Mjeshtër kërkimesh” dhe që kanë qenë ose janë titullarë lëndësh në shkollat e larta, ose autorë a bashkautorë tekstesh universitare, kanë të drejtë të përdorin përkatësisht titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.

4.10. Për personat, që kanë veprimtari shumë të shquar mësimore-shkencore, kulturore e shoqërore, të ushtruar për një kohë të gjatë, jepet titulli i nderit “**Doctor Honoris Causa**”. Ky titull jepet nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor, me propozimin e shkollës së lartë ose Akademisë së Shkencave, sipas udhëzimit të posaçëm.

5. Komisioni i Kualifikimit Shkencor (KKSH)

5.1. Krijimi dhe përbërja e Komisionit të Kualifikimit Shkencor bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kryetar i Komisionit të Kualifikimit Shkencor është Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Komisioni i Kualifikimit Shkencor përbëhet nga 15 anëtarë, ndër të cilët 6 persona zyrtarë të lartë, që mbulojnë fushat përkatëse dhe 9 përfaqësues me kualifikim të lartë nga fusha të ndryshme të shkencës. Për funksionimin e Komisionit të Kualifikimit Shkencor caktohet një sekretar, i cili drejton zyrën përkatëse, pranë kryetarit të këtij komisioni.

5.2. Komisioni i Kualifikimit Shkencor ka këto kompetenca:

5.2.1. Përcakton institucionet, që kanë të drejtë të hapin shkolla pasuniversitare, të japin diplomat e studimeve të thelluara pasuniversitare dhe gradën shkencore, si dhe të propozojnë për klasifikimin e personelit pedagogjik dhe shkencor.

5.2.2. Shqyrton propozimet për emërtimet pedagogjike-shkencore për çdo shkallë, si dhe jep miratimin përfundimtar për to.

5.2.3. Miraton juritë për mbrojtjen e disertacioneve.

5.2.4. Regjistron diplomat e doktoratës.

5.2.5. Harton dhe miraton rregullat e funksionimit të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

5.2.6. Harton dhe miraton rregulloret për veprimtaritë e mësipërme dhe nxjerr udhëzime për interpretimin e zbatimin e këtij vendimi dhe të rregulloreve.

6. Marrëdhëniet financiare

6.1. Shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin e shkollave pasuniversitare, përballohen nga buxheti i shkollave të larta, shtetërore ose private, pranë të cilave do të funksionojnë.

6.2. Kandidatët që pranohen në shkollat pasuniversitare, gjatë kohës së studimeve dhe përgatitjes së mikrotezës, mund të banojnë në qytetin e studentëve ose në konviktet e tjera të shkollave të larta dhe përfitojnë po ato lehtësi që u jepen studentëve. Gjithashtu, gjatë kohës së studimeve dhe përgatitjes së mikrotezës ata mund të trajtohen me bursë, sipas kritereve që caktohen nga Këshilli i Ministrave. Në çdo rast, trajtim me bursë nga shteti nuk përfitojnë personat me moshë 35 vjeç e lart.

6.3. Ngarkesa e pedagogëve dhe e punonjësve, që japin mësim në shkollat pasuniversitare, duke përfshirë udhëheqjen dhe mbrojtjen e mikrotezës, llogaritet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me një koeficient konvertimi më të lartë se sa personeli pedagogjik, që jep mësim në shkollat e larta.

6.4. Pjesëmarrja në juritë për mbrojtjen e disertacioneve shpërblehet jashtë ngarkesës mësimore të pedagogëve ose jashtë kohës së punës së punonjësve të tjerë, në masën e caktuar nga aktet nënligjore.

6.5. Udhëheqësit shkencorë të disertacionit, për kohëzgjatjen e përgatitjes së disertacionit nga disertanti, i njihet një ngarkesë, në orë mësimore, si shpërblim, në masën e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

6.6. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit Shkencor shpërblehen për çdo mbledhje, sipas masës së caktuar, me vendim të Këshillit të Ministrave.

6.7. Përballimi i shpenzimeve për doktoratën bëhet pjesërisht edhe nga kandidati, sipas një aktmarrëveshjeje, që lidhet me institucionin ku kryhet ndjekja e doktoratës.

6.8. Kur kandidati, që përfiton bursë nga shteti, nuk kryhen pa arsye detyrën e kualifikimit shkencor, detyrohet të kthejë shpenzimet që janë bërë për të.

7. Dispozitat e fundit

7.1. Komisioni i Kualifikimit Shkencor, me një udhëzim të veçantë, ka të drejtë t'i shpallë të barasvlefshme me gradën "Doktor" gradat shkencore, të fituara jashtë shtetit. Në këto raste nuk lëshohet diplomë e re doktorate, por mjafton një regjistrim pranë Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

7.2. Në rastet, kur kandidati ka kryer një shkollë pasuniversitare jashtë shtetit, dhe dëshiron të ndjekë përgatitjen e doktoratës, i paraqet shkollës së lartë universitare përkatëse dokumentacionin e plotë (diplomën, listën e notave, programin mësimor etj.). Institucioni përkatës ka kompetencë ta vlerësojë këtë dokumentacion dhe të vendosë barazvlefshmërinë e shkollës së huaj me shkollën pasuniversitare.

7.3. Mbrojtja e disertacioneve para jurive bëhet, si rregull, e hapur, përveç rasteve, kur për natyrën e veçantë të problemeve të trajtuara (konfidenciale, sekrete etj.), drejtuesi i institucionit autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar.

8. Dispozita kalimtare

8.1. Për personat që janë regjistruar në doktoratë me sistemin e vjetër dhe kanë shlyer detyrimet përkatëse, si dhe kanë paraqitur disertacionin, mbrojtja përpara jurisë duhet të bëhet deri në datën 30.6.1999.

8.2. Personave me veprimtari kërkimore-shkencore e pedagogjike, shumëvjeçare, që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë mbushur moshën 55 vjeç dhe që, për arsye të ndryshme, janë penguar të marrin gradë shkencore, u jepet e drejta që, deri në datën 30.6.1999, të paraqesin pranë Komisionit të Kualifikimit Shkencor kërkesën për gradën shkencore "Doktor". Kjo kërkesë do të përmbajë:

- curriculum vitae;
- vlerësim për veprimtarinë kërkimore-shkencore e pedagogjike nga titullarët e institucioneve ku ka punuar;
- dëshminë e provimit të një gjuhe të huaj, vlerësuar me notën 7 e lart. Ata që kanë mbaruar shkollat e larta jashtë shtetit, në vendet që kanë si gjuhë njërin prej atyre të treguara në pikën 2.4., nuk paraqesin dëshmi;
- një studim a monografi të botuar ose që ka gjetur zbatim në praktikë, të cilën i interesuari e paraqet për vlerësim në formë disertacioni.

Komisioni i Kualifikimit Shkencor merr vendimin për çdo kandidat dhe ua dërgon materialet institucioneve përkatëse, që kanë të drejtë të organizojnë mbrojtjen e doktoratës. Këta të fundit ngrenë një juri të posaçme për vlerësimin e kërkesës dhe për marrjen e vendimit përkatës, në përshtatje me një udhëzim të lëshuar nga Komisionit i Kualifikimit Shkencor.

8.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 30.6.1993 "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjike e kërkimore", vendimet nr. 538, datë 8.11.1993; nr. 177, datë 25.5.1994; nr. 495, datë 18.9.1995; nr. 698, datë 11.12.1995; nr. 352, datë 13.5.1996 "Për ndryshimet e vendimit të mësipërm",

si dhe vendimi nr. 130, datë 26.2.1996 “Për rishikimin e gradave shkencore” dhe aktet që rrjedhin prej tij, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 787, datë 17.12. 1998

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 643, DATË 18.10. 1998, “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENCAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 18.10.1998 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h”, me këtë përmbajtje:
“h) nxënësit dhe studentët, që janë trajtuar në vitet e mëparshme me bursë, si ish-të përndjekur politikë e përfitojnë këtë bursë gjatë gjithë viteve të studimit në shkollë”.
 2. Në pikën 14 numri i bursave për arsimin e mesëm ndryshohet nga 800 në 900.
 3. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre bursave shtesë të jetë datë 30.12.1998.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për vitin 1998.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 788, datë 17.12.1998

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 537, DATË 26.9.1994 “PËR SHITESË MBI PAGËN PËR KUALIFIKIM TË MËSUESVE DHE SHITESË PËR VEPRIMTARI TË INSPEKTORËVE TË ARSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 26.9.1994, pika 3 të ndryshohet si vijon:

“Inspektorëve të drejtorive arsimore në rrethe, drejtuesve të tyre, inspektorëve e drejtuesve të tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës u bëhet shtesë mbi pagë 15 për qind, për vështirësi shërbimi.”.

2. Efektet financiare, sipas këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1998, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 29.7.1997.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 789, datë 24.12.1998

PËR PLATFORMËN E FUNKSIONIMIT TË MINISTRISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të ligjit nr. 8415, datë 8.10.1998 “Për miratimin e strukturës dhe dhënien e votbesimit Këshillit të Ministrave të kryesuar nga zoti Pandeli Majko”, me propozimin e Ministrisë së Informacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Informacionit është pjesë e strukturës së Këshillit të Ministrave, e cila, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore drejton veprimtarinë e informimit të publikut dhe të medias.

2. Misioni i Ministrisë së Informacionit është:

- Të informojë publikun dhe median për veprimtarinë e qeverisë.
- Të informojë Këshillin e Ministrave për gjykimin që ka opinionin publik dhe media për veprimtarinë e tij.
- Të miratojë, të bashkërendojë dhe të ndjekë zbatimin e programeve dhe te projekteve të ministrive dhe të institucioneve qendrore për komunikimin me publikun dhe median, në përputhje me përparësitë e komunikimit të qeverisë.
- Përparësitë e komunikimit të qeverisë me publikun dhe median përcaktohen brenda muajit të parë të vitit, sipas një dokumenti të nënshkruar nga Kryeministri.

- Të ndërmarrë nisma ligjvënëse, që informacioni publik i veprimtarisë së qeverisë të miradministrohet si pasuri kombëtare, si dhe për të plotësuar legjislacionin në fushën e mediave.

3. Zëdhënësit e shtypit të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në prefektura, si dhe atashetë e shtypit, të akredituar në përfaqësitë tona diplomatike, jashtë shtetit, emërohen nga titullarët e këtyre institucioneve, me propozimin e Ministrisë së Informacionit.

4. Informacioni i zëdhënësve të shtypit për veprimtarinë e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, të prefekturave, si dhe informacioni i atashëve të shtypit, të akredituar në përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit, është i përditshëm dhe publikohet në formën e një “Buletini qeveritar”.

Kriteret e këtij informacioni përcaktohen në një udhëzim të posaçëm të ministrit të Informacionit.

5. Projektaktet normative, që paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave dhe në komitetet ndërministrorë, të shoqërohen me një “Komunikatë për shtypin”, e cila duhet të përmbajë informacion me interes për publikun dhe median.

6. Numri i punonjësve të Ministrisë së Informacionit përcaktohet nga Kryeministri. Në strukturën organizative të kësaj Ministrie të përfshihet edhe struktura e Departamentit të Medias, si dhe numri i punonjësve i parashikuar për të në organikën e Kryeministrisë.

7. Ngarkohet Ministria e Informacionit të përgatisë projektbuxhetin e vitit 1999 dhe të paraqesë në Këshillin e Ministrave projektvendimin me kërkesat përkatëse për fonde dhe mënyrën e përballimit të tyre. Efektet financiare për përballimin e shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 1998 të jenë respektivisht 470 000 lekë dhe 130 000 lekë. Këto efekte përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Për përmbushjen e nevojave emergjente për investime për vitin 1998, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare i pakësohet fondi për investime prej 6 milionë lekësh, të parashikuara për vitin 1998, të cilat i shtohen Ministrisë së Informacionit në zërin pajisje.

8. Pagat e punonjësve të Ministrisë së Informacionit të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, lidhja II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”.

Punonjësit e Ministrisë së Informacionit, me përjashtim të sektorit të personel-organizimit dhe shërbimeve, të marrin 45 për qind shtesë mbi pagën mujore, për shkak të veçorive specifike të punës.

9. Ngarkohet ministri i Informacionit të paraqesë për miratim, pranë Kryeministrit strukturën dhe organikën e Ministrisë së Informacionit brenda 5 ditëve nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 791, datë 24.12.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 694, DATË 21.10.1996 “PËR NORMËN MËSIMORE SHKENCORE NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE, AKTIVIZIMIN E PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E ARSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni nr.27, në ligjin 7592, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 53, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.694, datë 21.10.1996 pika 4, ndryshohet si vijon:

“a. Në arsimin parauniversitar, sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar, lejohet sipas nevojave të shkollës, por jo më shumë se 30 për qind e normës.

b. Në shkollat e larta, sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar, lejohet sipas nevojave të shkollës, por jo më shumë se 45 për qind e normës”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 21 milionë lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet edhe për vitin mësimor 1997-1998.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 796, datë 24.12.1998

PËR TË ARDHURAT E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË (QKK), PËR SHPËRBLIMET E KËSHILLAVE MIRATUESE TË PROJEKTEVE, TË KOMISIONIT TË VIZIONIMIT DHE TË KOMISIONIT FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

A. Të ardhurat jobuxhetore të QKK-së sigurohen si më poshtë:

1) 20 për qind e të ardhurave të filmit, që janë rezultat i subvencionit me fonde të QKK-së, i takojnë QKK-së. Pjesa tjetër i mbetet producentit.

2) 50 për qind e të ardhurave, që realizohen nga shitja dhe qarkullimi i veprave filmike, të prodhuara deri më 1.6.1997 me fonde buxhetore ose pjesërisht buxhetore. Pjesa tjetër i mbetet “Albafilm” Studios.

3) 1 për qind i shitjes së çmimit të biletave të sallave të shfaqjes së filmit.

4. Tarifat e regjistrimit të producentëve, distributorëve, si dhe ato për kategorizimin dhe licencimin e filmave caktohen nga QKK-ja, çdo vit.

B. Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratues të projekteve, komisionit financiar dhe komisionit të vizionimit janë:

1) Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratues të projekteve:

- 10 000 (dhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit artistik.

- 4 000 (katër mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit dokumentar.

- 2 000 (dy mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit vizatimor.

2) Shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar:

- 10 000 (dhjetë mijë lekë) për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit artistik.

- 4 000 (katër mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit dokumentar.

- 2 000 (dy mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit vizatimor.

3) Shpërblimet e anëtarëve të komisionit të vizionimit:

- 500 (pesëqind) lekë, kur filmi vizionohet në sallë.

- 200 (dyqind) lekë, kur filmi vizionohet në video.

Kryetarët e këshillave miratuese të projekteve, të komisionit të vizionimit dhe të komisionit financiar paguhen 20 për qind më shumë se anëtarët e tjerë.

4) Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë që nga data e krijimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 798, datë 24.12.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 54, DATË 2.2. 1996 “PËR LISTËN E BARNAVE QË RIMBURSOHEN DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1996 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 2.2.1996, pika 3 ndryshohet si vijon:

1. 3. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave kryesore që rimbursohen, sipas grupeve është:

Grupi I 100 për qind

Barna për mjekimin e sëmundjeve tumorale

Barna për mjekimin e sëmundjes së tuberkulozit

Grupi II 75-99 për qind

Antiepileptikë

Antineoplazikë

Antidodë

Hormone, kontraktivë, endokrinologji

Miorelaksant

Oksitocikë dhe antioksidant

Psikotropë

Barnat që veprojnë në rrugët e frymëmarrjes

Vitamina e kripëra minerale.

Grupi III 55-74,9 për qind

Analgezicë dhe antipireticë

Antiinfektivë

Antialergjikë

Antiparkinsonikë

Dermatologjikë

Të hematologjisë

Gastrointestinal

Oftalmologji

Grupi IV - 37.5 - 54.9 për qind

Antimigrenozë

Diuretikë

Kardiovaskularë

Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave kryesore që rimbursohen sipas kësaj pike, është 100 për qind për grupet që vijon:

- Fëmijë 0-12 muaj
- Invalidë të grupit I-II
- Invalidë lufte
- Veteranë.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 9.5.1997 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 2.2.1996 “Për listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave”” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 802, datë 24.12.1998

PËR SHITJEN E PASURIVE TË SHOQËRIVE NË ADMINISTRIM “UNIVERSI”, SH.P.K., “NAHLEL” SH.P.K., “ASERD” SH.P.K., PËR RIKOMPENSIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridike, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pasuritë e shoqërive në administrimin “Universi”, sh.p.k., “Nahlel” sh.p.k., dhe “Aserd” sh.p.k., të shiten në përputhje me rregullat e caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.493, datë 13.8.1998.

2. Shitja e pasurive të shoqërive në administrim, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të kryhet nga administratorët e caktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 16.7.1998.

3. Të ardhurat që do të sigurohen nga shitja e pasurive të shoqërive në administrim, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të përdoren për rikompensim të vlerave financiare kreditorëve të tyre, sipas koeficientit të kthimit të shumave, i cili është i veçantë për secilën nga shoqëritë e mësipërme.

Rregullat për kthimin e vlerave financiare janë të njëjta me ato që zbatohen për kreditorët e shoqërive huamarrëse, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 8.9.1998.

4. Ngarkohet Grupi Mbikëqyrës pranë Këshillit të Ministrave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 804, datë 24.12.1998

PËR MBYLLJEN E PROCESIT TË KONTROLLIT DHE TË ADMINISTRIMIT PËR SHOQËRITË “AGRONI” SH.P.K. DHE “KAMBO MARSHALL” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procesit të kontrollit dhe të administrimit të shoqërive tregtare “Agroni”, sh.p.k., dhe “Kambo Marshall”, sh.p.k., të kryera nga ekspertët financiarë vendas, të pavarur.

2. Grupi Mbikëqyrës dhe ekspertët financiarë vendas, dokumentacionin e grumbulluar gjatë periudhës së kontrollit dhe të administrimit të shoqërisë “Agroni”, sh.p.k., dhe “Kambo Marshall”, sh.p.k., t’ua kalojnë organit të prokurorisë, për fillimin e procedurave hetimore e gjyqësore ndaj ish-administratorëve të këtyre shoqërive.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

U dorëzua për shtyp më 24.03.2000
Doli nga shtypi më 27.03.2000

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x80/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta” sh.p.k

Çmimi: 100 lekë